



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:904342
Datë: 14.05.2024
Numri i dokumentit: 05678470

C.nr.4540/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditësve S.O, E.O, E.O, E.O, E.O dhe S.O, të gjithë nga P, të përfaqësuar në bazë të autorizimit nga F.P, avokat me seli në P, kundër të paditurve: 1) N "B", me seli në fshatin B, Komuna F.K, e përfaqësuar në bazë të autorizimit nga Shoqëria e Avokatëve "K & P", me seli në P dhe 2) Kompania e Sigurimeve "S", me seli në P, e përfaqësuar në bazë të autorizimit nga M.D, avokat me seli në P, me objekt kontesti kompensimin e dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 70,922.00 €, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor - publik të dt.26.04.2024, në prezencën e përfaqësuesit të autorizuar të paditësve, av. F.P, përfaqësueses së autorizuar të të paditurës së parë, av. F.SH, si dhe përfaqësuesit të autorizuar të të paditurës së dytë, av. M.D, me datë 08.05.2024 mori, ndërsa me datë 13.05.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditësve S.O, E.O, E.O, E.O, E.O dhe S.O, të gjithë nga P, ashtu që: DETYROHEN të paditurat: 1) N "B", me seli në fshatin B, Komuna F.K dhe 2) Kompania e Sigurimeve "S", me seli në P, që secila veç e veç, në emër të dëmit të shkaktuar si pasojë e humbjes së jetës të anëtarit të familjes U.O nga aksidenti në vendin e punës me datë 16.05.2009, t'ua paguajnë paditësve shumat si në vijim:

-E paditura e parë, N "B", në emër të dëmit jo material - dhimbjeve shpirtërore të përjetuara si pasojë e humbjes së anëtarit të familjes:

- Paditëses S.O, shumën prej.....5,000 €;
- Paditëses S.O, shumën prej.....5,000 €;
- Paditësit E.O, shumën prej.....3,500 €;
- Paditësit E.O, shumën prej.....2,500 €;
- Paditëes E.O, shumën prej.....3,700 €;
- Paditëses E.O, shumën prej.....4,000 €.

-Në emër të rentës për mbajtje, për periudhën kohore 16.05.2009 - 31.12.2017, shumën e përgjithshme në vlerë prej 12,772.41 €, ndërsa për periudhën nga data 01.01.2018, e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, në emër të pagës së besueshme që do të mund ta realizonte tani i ndjeri

U.O po të ishte në jetë, shumën prej 318.00 € për çdo muaj, dhe atë më së largu deri me datën 05 të çdo muaji vijues.

-E paditura e dytë, Kompania e Sigurimeve "S", në emër të dëmit material:

-Për shpenzimet e varrimit, shumën prej.....400.00 €;

-Për ngritjen e lapidarit për të ndjerin U.O, shumën prej.....800.00 €;

-Për pritjen dhe përcjelljen në ngushëllime, shumën prej.....600.00 €.

II. DETYROHEN të paditurat N "B", me seli në fshatin B, Komuna F.K dhe Kompania e Sigurimeve "S", me seli në P, që paditësve, secila veç e veç, shumat e gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ua paguajnë së bashku me normën e kamatës e cila vlen si për mjetet e depozituara në bankat afariste që operojnë në Republikës e Kosovës, në afat më tepër se një vit, pa destinim të caktuar, e cila për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit, dt.13.05.2024, e deri në pagesën definitive, ndërsa për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit material do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë, dt.26.10.2009, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

III. REFUZOHET E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve ndaj të paditurave N "B", me seli në fshatin B, Komuna F.K dhe Kompania e Sigurimeve "S", me seli në P, përtej shumave të gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë: në emër të dëmit jo - material - dhimbjeve shpirtërore të përjetuara, për paditësen S.O, në shumën prej 4,000 €, për paditësen S.O, në shumën prej 4,000 €, për paditësin E.O, në shumën prej 5,500 €, për paditësin E.O, në shumën prej 6,500 €, për paditësen E.O, në shumën prej 5,300 €, si dhe për paditësen E.O, në shumën prej 5,000 €. Po ashtu, refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve ndaj të paditurave përtej shumave të gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi në emër të dëmit material, dhe atë: për shpenzimet e varrimit në shumën prej 550.00 €, për ngritjen e lapidarit për të ndjerin U.O, në shumën prej 700.00 €, si dhe për pritjen dhe përcjelljen në ngushëllime në shumën prej 900.00 €.

IV. DETYROHET e paditura e parë N "B", me seli në fshatin B, Komuna F.K, që paditësve S.O, E.O, E.O, E.O, E.O dhe S.O, në emër të shpenzimeve të krijuara në këtë procedurë kontestimore t'ua paguajë shumën e përgjithshme prej 6,725.00 € (gjashtë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë euro), ndërsa DETYROHET e paditura e dytë, Kompania e Sigurimeve "S", me seli në P, që paditësve, në emër të shpenzimeve të krijuara në këtë procedurë t'ua paguajë shumën e përgjithshme prej 330.90 € (treqind e tridhjetë euro e nëntëdhjetë cent), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

- Rrjedha e procedurës dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse -

Paditësit S.O, E.O, E.O, E.O, E.O dhe S.O, të gjithë nga P, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me dt.26.10.2009, pranë ish Gjykatës Komunale në Prishtinë, kanë parashtruar padi, fillimisht kundër të paditurës N "B", me seli në fshatin B, Komuna F.K, me objekt kontesti kompensimin e dëmit material dhe jo material, lëndë kjo e cila është evidentuar nën shenjën C.nr.2391/09. Përmes

parashtrësës së dt.05.04.2016, është bërë zgjerimi i padisë në aspektin subjektiv, në atë mënyrë që në cilësinë e palës së paditur është përfshirë edhe Kompania e Sigurimeve "S", me seli në P.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes aktgjykimit C.nr.2391/09, të dt.18.05.2018, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vepruar sipas ankesave të parashtruara nga përfaqësuesit e autorizuar të palëve ndërgjyqëse, përmes aktvendimit Ac.nr.4186/18, të dt.18.08.2022, e ka anuluar aktgjykimin e lartëcekur të gjykatës së shkallës së parë, duke e kthyer lëndën në rigjykim dhe rivendosje. Me rastin e kthimit në rivendosje, lënda ka marrë numrin C.nr.4540/22.

Në riprocedim, kjo Gjykatë në kuptim të vërejtjeve dhe sugjerimeve nga aktvendimi i lartëcekur i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4186/18, i dt.18.08.2022, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën përgaditore me dt.25.01.2024, si dhe seancat e shqyrtimit kryesor me dt.21.02.2024, 17.04.2024 dhe 26.04.2024.

Në seancat e mbajtura, ashtu edhe në fjalën përfundimtare, të deponuar në formë të shkruar, i autorizuari i paditësve, av. F.P, ndër tjera ka theksuar se mbetet në tërësi pranë kërkesëpadisë, precizimit të padisë dhe deklarimeve nga seancat e kaluara, duke shtuar tutje se baza e kërkesëpadisë vërtetohet nga provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës, duke e vënë theksin e veçantë tek ekspertizat e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, të përpiluara nga ekspertët Dr. B.B dhe Dr. A.K, sipas të cilave është konstatuar se deri te lëndimi ka ardhur për shkak se punëdhënësi e ka angazhuar tani të ndjerin U.O pa kualifikim përkatës, pa aftësi përkatëse profesionale, pa e trajnuar profesionalisht dhe pa e aftësuar për siguri dhe mbrojtje për punë të tilla. Më tej pretendohet se të ndjerit nuk i është dhënë doracaku për manipulim dhe mbrojtje në punë, montimi dhe çmontimi i kundërpeshës së eksavatorit në fjalë është tentuar të bëhet me punëmarrës jo profesionist, i cili nuk e ka kuptuar fare se çka është kundërpeshja, rolin e saj, funksionin që kryern si dhe kuptimin e ekuilibrit statik dhe dinamik për të cilin ka nevojë eskavatori. Tutje i autorizuari i paditësve i është referuar nenit 11 par.1 të Rregullores për Siguri në Punë, Shëndet dhe Mjedisin e Punës, sipas së cilës përgjegjësinë e mban e paditura e parë, e cila nuk i ka marë masat parandaluese, sidomos nuk ka bërë vlerësimin e rreziqeve në punë, përfshirë kontrollin sistematik të mjetve dhe pajisjeve të punës. Tutje i është referuar kontratës së punës të dt.03.01.2009, të lidhur në mes të të paditurës së parë N "B" si punëdhënëse dhe tani të ndjerit U.O si punëmarrës, nga e cila thekson se vërtetohet që i ndjeri ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të caktuar, prej datës 03.01.2009 e deri me datë 03.01.2010 tek e paditura. Më tej i është referuar policës së sigurimit nr..., nga e cila thekson se vërtetohet fakti që e paditura e parë e ka siguruar tani të ndjerin tek e paditura e dytë Kompania e Sigurimeve "S". Baza e përgjegjësisë së të paditurës së parë, sipas përfaqësuesit të autorizuar të paditësve buron nga paragrafi 10 i nenit 2 të Ligjit Nr.2003/19 për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 01.08.2007, i cili ka qenë në fuqi në kohën e aksidentit. Po ashtu, i autorizuari i paditësve i është referuar edhe paragrafit 3 të nenit 6 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me dt.24.06.2013. Pretendimet e të paditurës së parë lidhur me mungesën e legjitimitetit pasiv i ka konsideruar të pa bazuara, ndërsa në vijim të pretendimeve i është referuar edhe marrëveshjes ndërmjet të paditurës dhe "R.E", të lidhur me datë 25.10.2008, sipas së cilës e paditura ka qenë nënkontraktore e kësaj të fundit, e sipas së cilës marrëveshje e paditura ka qenë e obliguar që për periudhën kohore 11/2008 deri me 11/2009 të garantojë dhe të ofrojë shërbime teknike, kualitative dhe profesionale, duke pretenduar tutje se kjo marrëveshje është lidhur para se të punësohet tani i ndjeri U.O tek e paditura e parë, andaj i njejt

nuk ka pasur asnjë kontratë pune apo marrëveshje me "R.E". Në këtë kuptim, duke iu referuar nenit 5 të marrëveshjes ndërmjet të paditurës së parë dhe "R.E", dispozitë kjo e cila është cituar, pretendohet se e njejta mbulon edhe çështjen e sigurisë dhe mbrojtjes në punë, që duhet të garantohet nga nënkontraktuesi, andaj lëshimet e evidentuara në pikën b) të ekspertizës së mbrojtjes në punë të përpiluar nga Dr. A.K, që i referohen lëshimeve të kompanisë "R.E", i ka propozuar Gjykatës që mos t'i marrë parasysh. Më tej i është referuar edhe ekspertizës financiare të përpiluar nga eksperti A.B me dt.26.12.2017, sipas së cilës pretendon që vërtetohet fakti se i ndjeri U.O ka qenë i punësuar tek e paditura e parë, e po ashtu vërtetohet fakti se e paditura ia ka paguar bashkëshortes së të ndjerit S.O shumën prej 200.00 Euro në muaj për periudhën kohore 01.06.2009 e deri në tetor të vitit 2016. Po sipas kësaj ekspertize, pretendohet që është vërtetuar fakti se paga të cilën do ta realizonte tani i ndjeri në qoftë se do të ishte i punësuar tek e paditura apo ndonjë punëdhënëse tjetër gjatë periudhës nga vdekja aksidentale me datë 16.05.2009, e deri me datën 31.12.2007 arrin në shumën prej 12,772.41 Euro dhe për periudhën e ardhshme prej datës 01.01.2018 e tutje, deri sa të mos ndryshojnë rrethanat ekonomike në Kosovë, paga e besueshme që do të realizonte i ndjeri vlerësohet se do të ishte 318.00 Euro në muaj. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar pretendohet se u përket të paditurave në mënyrë solidare dhe atë: e paditura e parë si punëdhënëse e tani të ndjerit, ndërsa e paditura e dytë, si siguruese e të njejtit. Mbi këtë bazë, i ka propozuar Gjykatës që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësve në kuptim të dispozitës së nenit 201 të LMD-së, ashtu që familjarëve të të ndjerit t'ua aprovojë shumat në të holla në emër të dëmit jo material, për secilin veç e veç shumën prej nga 9,000 €, duke marrë parasysh dhimbjet shpirtërore, vuajtjet që kanë pësuar si pasojë e humbjes së bashkëshortit, babait dhe djalit, si dhe mbi bazën e traditave dhe praktikës gjyqësore, konform nenit 193 të LMD-së, ta aprovojë kërkesëpadinë sa i përket dëmit material, dhe atë: në emër të ngritjes së lapidarit shumën prej 1,500 €, në emër të shpenzimeve të varrimit shumën prej 950.00 €, si dhe në emër të pritjes dhe përcjelljes në ngushëllime shumën prej 1,700 €, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur nga dita e shkaktimit të dëmit, dt.16.05.2009, e deri në pagesën përfundimtare. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuara në fjalën përfundimtare, në shumën e përgjithshme prej 13.080.40 €.

E paditura e parë, N "B", me seli në fshatin B, Komuna F.K, përmes përfaqësueses së autorizuar, av. F.SH, në seancat e mbajtura, ashtu edhe në fjalën përfundimtare të deponuar në formë të shkruar me dt.07.05.2024, ndër tjera ka theksuar se qëndron në tërësi pranë përgjigjes në padi, thënieve dhe kundërshtimeve nga fazat e mëhershme të kësaj procedure, duke e kontestuar në tërësi padinë në kuptim të bazës dhe lartësisë së saj. Pretendon që të paditurës së parë i mungon legjitimiteti real pasiv në këtë çështje juridike kontestimore dhe një pretendim të tillë e mbështetë në kontratën e lidhur me "R.E" me dt.25.10.2008, duke u bazuar po ashtu edhe në konstatimet e dhëna në raportin zyrtar të TEIP nr.42/09, të datës 15.07.2009, si dhe në faktin që "R.E" ka pasur kontratë të lidhur me subjektin "T.G", për realizimin e projektit mbi riparimin e eksavatorit, në të cilën kontratë ka garantuar se do të zbatojë shërbimet në mënyrë të drejtë dhe kualitative, e po ashtu ka garantuar se mjetet ngritëse janë të përshtatshme për të kryer punë të veçanta dhe konform rregullave për sigurinë në punë. Tutje theksohet se duke pasë parasysh faktin që i ndjeri në momentin e aksidentit ka qenë duke kryer punë dhe detyra në objektin e "R.E", nën mbikëqyrjen e personelit të kësaj të fundit, në kuptim të nenit 19 par.1, lidhur me par.3 të Ligjit të Punës, të paditurës i mungon legjitimiteti pasiv. Përgjegjësia e të paditurës, sipas pretendimeve të përfaqësueses së autorizuar përjashtohet edhe në bazë të faktit se të gjithë punëtorët e vet ishin të siguruar tek e paditura e dytë, Kompania e Sigurimeve "S", fakt ky i cili dëshmohet në bazë të policës së sigurimit nr..., valide prej datës 26.01.2009, e deri me datë 26.01.2010. Me rastin e sigurimit të të punësuarve për lëndimet/aksidentet në vendin e punës,

pretendohet se e tërë përgjegjësia për kompensimin e dëmit kalon mbi siguruesin (kompaninë e sigurimeve). E paditura e parë pretendon që ka përmbushur obligimin ligjor që parashihet me nenin 60 të Ligjit të Punës me rastin e sigurimit të punëtorit – tani të ndjerit U.O, andaj i vetmi subjekt që ka legjitimitet pasiv dhe mund të konsiderohet përgjegjës për shpërblimin e dëmit ndaj paditësve është e paditura e dytë. Përtej kontestimit të përgjegjësive për kompensimin e dëmit material dhe jo-material, e paditura e parë e ka konstestuar edhe ekspertizën nga lëmia e sigurisë dhe mbrojtjes në punë, të përpiluar nga eksperti A.K, me datë 14.03.2024, duke theksuar se e njëjta përmban të gjetura të cilat janë dhënë në mënyrë paushalle dhe që nuk sqarojnë në mënyrë të duhur se si ka ardhur deri te lëshimet e të paditurës së parë. Bazuar në këto pretendime, ka propozuar që kërkesëpadia e paditësve në raport me këtë të paditur, të refuzohet në tërësi si e pa bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuar në fjalën përfundimtare, dhe atë në shumën e përgjithshme prej 2.849.60 Euro.

E paditura e dytë, Kompania e Sigurimeve “S”, me seli në P, përmes përfaqësuesit të autorizuar, av M.D, në seancat e mbajtura ashtu edhe në fjalën përfundimtare, ndër tjera ka pretenduar se në bazë të policës së sigurimit, maksimumi i mbulesës arrin shumën prej 2,000 Euro, ndërsa lidhur me kategoritë tjera të dëmit që janë objekt i kërkesëpadisë, të njëjtat nuk mbulohen me këtë policë. Më tej pretendon se me provat e administruara është vërtetuar ndarja e përgjegjësive në mes të tri palëve me rastin e ndodhjes së aksidentit tragjik. Për të paditurën e dytë nuk është kontestuese se në mes të dy të paditurave ka qenë e lidhur kontrata për aksidente personale, mirëpo mbi bazën e vetë policës me nr..., konstatohet se shuma e siguruar ka qenë në vlerë prej 44 mijë euro dhe numri i siguruar i punëtorëve ka qenë 22, andaj mbi bazën e përpjesëtimit, shuma maksimale e mbulueshmërisë ka qenë vlera prej 2,000 Euro. Një fakt i tillë, sipas të paditurës së dytë vërtetohet edhe mbi bazën e kushteve të përgjithshme të përcaktuara me këtë kontratë, andaj përgjegjësia e të paditurës së dytë në raport me kompensim konsiston në shumën maksimale prej 2,000 Euro, duke i zbritur kësaj përgjegjësive e vetë të ndjerit dhe përgjegjësive eventuale të nënkontraktuesit të të paditurës së parë. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, i ka propozuar Gjykatës që me rastin e vendosjes, kërkesëpadinë e paditësve në raport me të paditurën e dytë ta aprovojë në nivel të shumës së siguruar maksimale prej 2,000 Euro. Lidhur me shpenzimet e procedurës ka propozuar që të vendoset në bazë të suksesit dhe të njëjtat nuk i ka kërkuar.

- Gjendja faktike e vërtetuar mbi bazën e provave të administruara -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike, Gjykata në riprocedim, në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.26.04.2024, gjatë procedurës së administrimit të provave, ka administruar provat materiale nga procesverbali i seancës së shqyrtimit kryesor i evidentuar nën shenjën C.nr.2391/09, i dt.18.05.2018, dhe atë: Kontrata e punës e dt.03.01.2009; Polica e sigurimit nr...; Lista e punëtorëve të të paditurës së parë; Certifikata e sigurimit nr..., e dt.26.01.2009; Urdhëri për pagesë periodike i dt.18.08.2012; Gjendja e xhirollogarisë, e lëshuar nga ..., e dt.06.02.2015; Marrëveshja ndërmjet “R.E” dhe N “B”, e dt.25.10.2008; Ekspertiza financiare e dt.26.12.2017; Oferta e dt.13.01.2009; Certifikatat e lindjes për E, E, E dhe S.O; Certifikata e vdekjes për të ndjerin U.O; Deklarata e bashkësisë familjare e dt.21.11.2017; Raporti zyrtar i TEIP nr.42/09, i dt.15.07.2009; Ekspertiza nga lëmia e mbrojtjes në punë e dt.05.05.2016; Ekspertiza mjekësore nga lëmia e psikiatrisë e dt.01.10.2016; Ankesa e dt.16.10.2009; Parashtrësia me vërejtjes nga raporti zyrtar i TEIP i dt.22.07.2009; Raporti policor nga njësia e hetuesisë nr.PPN.330-1/09, i dt.22.07.2009; Vërtetimi mbi vdekjen e të ndjerit U.O, së

bashku me raportet mjekësore; Njoftimi lidhur me aksidentin, drejtuar Prokurorisë së Qarkut i dt.08.09.2009; Procesverbali i dt.03.09.2009. Po ashtu, në riprocedim në cilësinë e provës është nxjerrë edhe ekspertiza nga lëmia e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, e përpiluar nga eksperti A.K, me dt.14.03.2024, së bashku me sqarimet plotësuese të dhëna në seancën e dt.26.04.2024.

Gjykata në mbështetje të dispozitës së nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, me ç'rast ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Tani i ndjeri U.O, kishte themeluar marrëdhënien e punës me të paditurën e parë N "B", me seli në fshatin B, Komuna F.K, dhe atë në bazë të kontratës së punës të lidhur me datë 03.01.2009. Sipas nenit 2 të kësaj Kontrate, punonjësi është sistemuar në vendin e punës punëtor fizik, ndërsa sipas nenit 3, palët janë dakorduar që punët e përcaktuara në nenin 2 do të kryhen në selinë e punëdhënësit. Në nenin 4 bëhet fjalë për kohëzgjatjen e kontratës, ku është specifikuar se punonjësi e fillon punën me datë 03.01.2009 deri me datë 03.01.2010, me mundësi vazhdimi. Në dispozitat në vijim të kontratës është rregulluar çështja e orarit të punës, pushimeve, pagesës së të ardhurave, mundësia e shkëputjes së kontratës, ndërsa në nenin 10 është paraparë se punonjësi deklaron se me rastin e punësimit është njoftuar me rregullat e mbrojtjes në punë, pastaj me pasojat e mundshme për mos zbatim të rregullave të mbrojtjes në punë apo mos përdorimin e mjeteve mbrojtëse.

E paditura e parë, N "B", përmes policës së sigurimit nr..., kishte siguruar nga aksidentet personale 22 të punësuar tek e paditura e dytë Kompania e Sigurimeve "S", me kohëzgjatje për periudhën kohore 26.01.2009 - 26.01.2010. Në mesin e personave të siguruar bën pjesë edhe tani i ndjeri U.O, fakt ky i cili vërtetohet në bazë të policës së lartëcekur dhe listës së punëtorëve të të paditurës së parë, fakt ky i cili për më tepër nuk rezulton të jetë kontestues mes palëve ndërgjyqëse. Në bazë të certifikatës së sigurimit nr.19, të dt.26.01.2009, vërtetohet fakti se shuma e mbulimit për të siguruarin U.O konsiston në shumën prej 2,000 Euro.

E paditura e parë N "B", me datë 25.10.2008, në cilësinë e nënkontraktorit, kishte lidhur marrëveshje me subjektin "R.E", në cilësinë e kontraktuesit. Në nenin 1, ku bëhet fjalë për subjektin e kontratës theksohet se "*Meqenëse nënkontraktuesi ka kontratë me T.G për mbrojtjen nga korrozioni të ekskavatorit sipas projektit "Riparimi i eskavatorit Rotorik E10 në MS B, palët kontraktuese pajtohen që nënkontraktori t'i ofrojë kontraktuesit shërbime teknike (fuqi punëtore)".* Në nenin 2 palët janë dakorduar që shërbimet të ofrohen për periudhën kohore 11/2008 deri 11/2009. Në nenet 3 dhe 4 janë normuar çështje që kanë të bëjnë me çmimin dhe pagesën, ndërsa në nenin 5 është paraparë që nënkontraktuesi duhet të garantojë shërbime kualitative dhe profesionale.

Me datën 16.05.2009, rreth orës 13:45, në vendpunishten në Mihjen Sipërfaqësore në fshatin B.M, Komuna F.K, gjatë realizimit të projektit "Riparimi i Eskavatorit Rotorik SRS 1300+VR", kishte ndodhur një aksident me pasoja fatale për punonjësin - këtu të ndjerin U.O.

Në bazë të vërtetimit për vdekjen e të ndjerit U.O, së bashku me raportet mjekësore, vërtetohet fakti se i njejti ka ndërruar jetë me datën 16.05.2009, në orën 14:52, si pasojë e lëndimeve vdekjeprurëse të pësuar si pasojë e aksidentit në vendin e punës.

Rrethanat e këtij aksidenti fillimisht janë evidentuar në bazë të raportit zyrtar të Trupit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës nr.42/09, të datës 15.07.2009. Në këtë raport, ndër tjera është konstatuar se i ndjeri U.O ishte punëtor i N "B", ndërsa në momentin e aksidentit ishte duke punuar për "R.E" sh.p.k,

me të cilën kishte marrëveshje për kryerjen e shërbimeve dhe punëve me këtë subjekt afarist. I ndjeri po ashtu ishte i siguruar tek e paditura e dytë K.S "S". Tutje është konstatuar se përgjegjësia për mbrojtje dhe siguri në punë i është bartur subjekteve afariste N "B", me seli në F.K, me pronar RR.M dhe "R.E" sh.p.k. Punëdhënësit kanë qenë përgjegjës për organizimin dhe zbatimin e masave për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës, kështu që kanë dështuar në organizimin dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme në këtë drejtim, duke mos ofruar mbrojtje të shëndetit të të punësuarve, parandaluar rreziqet në punë, ofrimin e informatave, trajnimeve, organizimit përkatës dhe masave të duhura për të siguruar, mirëmbajtur makineritë, instrumentet, pajisjet, veglat në vendin e punës, e po ashtu nuk kanë bërë vlerësimin e hollësishëm mbi rreziqet për secilin vend të punës, me çka është konstatuar se subjektet e lartëcekura kanë bërë shkelje të dispozitave të neneve 2.1, 2.2, 2.3, 2.4 dhe 2.8 të Ligjit Nr.2003/19 për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës.

Nga parashtrësia me vërejtjet në raportin zyrtar të TEIP, të përpiluar nga e paditura e parë me dt.22.07.2009, vërtetohet fakti se e njëjta përmes drejtorit, z.RR.M kishte paraqitur vërejtjet ndaj raportit të elaboruar më sipër, duke kërkuar që të gjitha konstatimet në lidhje me përgjegjësinë e kësaj kompanie për organizimin dhe zbatimin e masave për siguri në punë dhe vlerësimin e hollësishëm të rreziqeve për secilin vend të punës, të largohen nga raporti, me arsyetim se kompania nuk ka qenë e ngarkuar me këto përgjegjësi.

Përmes ankesës së st.16.10.2009, e paditura e parë, përmes drejtorit z.RR.M kishte parashtruar ankesë ndaj vendimit nr.42/09, të dt.27.09.2009, me të cilin ishte gjositur në shumën prej 9,500.00 Euro, për shkak të cenimit të dispozitave nga nenet 2.1, 2.2, 2.3, 2.4 dhe 2.8 të Rregullores nr.2003/33 për shpalljen e Ligjit Nr.2003/19 për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës.

Nga raporti policor nga njësia e hetuesisë nr.PPN.330-1/09, i dt.22.07.2009, është konstatuar fakti se me datën 16.05.2009, rreth orës 13:45 është raportuar rasti i një lëndimi trupor që dyshohej se kishte ndodhur në Mihjen Siperfaqësore në B.M, gjatë riparimit të eskavarotëve të mihjes.

Nga njoftimi lidhur me aksidentin, drejtuar Prokurorisë së Qarkut me datë 08.09.2009, si dhe provesverbali i dt.03.09.2009, vërtetohet fakti se Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale e ka njoftuar ish Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë, lidhur me aksidentin me pasoja vdekjeprurëse për të ndjerin U.O me dt.16.05.2009 në eskavatorin rotorik në fshatin B.M. Po ashtu nga procesverbali i lartëcekur është konstatuar se në të njëjtën datë dhe vend, tani i ndjeri përderisa ishte duke punuar në ndërrimin e mbajtësit të kushinetës së dytë të kundërpeshës, në eskavatorin rotorik E 10, të tipit Srs-1300+Vr (19010), kundërpesha nuk ka qenë e siguruar mirë dhe ka rënë mbi trupin e të ndjerit, duke i shkaktuar lëndime vdekjeprurëse.

Në procedimin e mëhershëm, është nxjerrë prova përmes ekspertizës nga lëmia e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, e cila është përpiluar nga eksperti Dr. B.B - inxhinier i makinerisë me dt.05.05.2016. Në këtë ekspertizë janë elaboruar rrethanat e aksidentit si dhe lëshimet e subjekteve të përfshira. Në mesin e udhëzimeve të dhëna nga Gjykata e Apelit e Kosovës përmes aktvendimit Ac.nr.4186/18, të dt.18.08.2022, ka qenë edhe udhëzimi që të ftohet eksperti përkatës, me qëllim që i njëjti në mënyrë të detajuar të sqarojë rrethanat se si ka ndodhur fatkeqësia në vendin e punës, e sidomos kontributin e punëdhënësit - këtu të paditurës së parë dhe eventualisht të të ndjerit, mbi bazën e arsyetimit se nga kjo ekspertizë nuk është sqaruar në mënyrë të plotë dhe të nevojshme për të vendosur sipas

kërkesëpadisë së paditësve. Gjykata ka komunikuar me ekspertin e lartëcekur në drejtim të njoftimit për të prezantuar në seancë dhe për të dhënë sqarimet plotësuese, mirëpo ka marrë përgjigjen se i njëjti për shkak të moshës së shtyrë dhe gjendjes shëndetësore nuk është në dispozicion. Mbi këtë bazë, sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të palëve paditëse, është bërë nxjerrja e provës përmes eksptizës së re nga lëmia e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, me ç'rast është përzgjedhur Dr. A.K, i cili ka përpiluar mendimin dhe konstatimin me shkrim me dt.14.03.2024, ndërsa ka dhënë sqarimet plotësuese në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.26.04.2024.

Në këtë ekspertizë, fillimisht është bërë një përshkrim i rrethanave të ndodhjes së aksidentit, ku është cekur se me dt.16.05.2009, tani i ndjeri U.O, së bashku me punëtorin tjetër N.V, ishin dërguar të punonin për firmën "R.E", në ndërrimin e kushinetave në mbajtësin e kundërpeshtës së eskavatorit E-10, tipi SRs-1300 Vr 19010, duke shtuar tutje se eskavatori ka qenë i vendosur në platonë e servisimit të mihjeve sipërfaqësore në B.M. Tutje është konstatuar se meqë kundërpeshta nuk kishte qenë e siguruar nga rënia siç duhet, e njëjta ka rënë nga veprimi i peshës vetanake, duke e nxënë punëtorin U.O dhe duke i shkaktuar në këtë mënyrë pasoja fatale. Tutje në këtë ekspertizë janë përshkruar provat materiale të cilat kanë shërbyer për përpilimin e të njëjtës, janë komentuar dispozitat e kontratës së lidhur në mes të të ndjerit U.O dhe të paditurës së parë, dispozita të marrveshjes mes të paditurës së parë dhe subjektit "R.E", konstatimet nga raporti zyrtar i TEIP të dt.15.07.2009, është bërë një përshkrim teknik i kushteve të punës të cilat duhet plotësuar në vendin e punës në të cilin ka ndodhur aksidenti si dhe janë bërë ilustrime përmes fotografive nga vendi i ngjarjes.

Eksperti përkatës ka dhënë mendimin përfundimtar se shkaqet e lëndimit vdekjeprurës të punëtorit U.O me dt.16.05.2009, në eskavatorin rotorik E-10 SRs-1300 në B.M janë: 1) Lëshimet e punëdhënësit të punëtorit të ndjerë (kompanisë "B"; 2) Lëshimet e kompanisë për të cilën punëtori ka qenë duke kryer punë (kompanisë "R.E", por përmes kompanisë "B" në çastin kritik dhe 3) Lëshimet e punëmarrësit U.O. Në raport me kompaninë "B" - këtu të paditurën e parë, eksperti ka evidentuar këto lëshime: *"Nuk ka definuar në Marrëveshjen me shkrim me Kompaninë "R.E" se cilën strukturë të përgaditjes profesionale duhet ta kenë punëtorët që do t'ia ofrojnë kësaj kompanie si fuqi punëtore të paraparë me nenin 1 të kontratës së datës 25.10.2008; Nuk ka definuar përmes marrëveshjes me shkrim të datës 25.10.2008, çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes në punë gjatë realizimit të punimeve sipas kësaj marrëveshje; Nuk ka bërë vlerësimin e rrezikshmërisë së vendeve të punës në nivel të Kompanisë dhe konform nivelit të dalur të rrezikut të parasheh dhe ndërmarrë masat adekuate parandaluese (nuk ka zbatuar nenin 2, paragrafi 2.4 të Ligjit Nr.2003/19); Ka angazhuar në punë me rrezikshmëri të lartë punëtorin, i cili nuk ka pasur përgaditje shkollore adekuate, aftësim plotësues profesional e as përvojë për kryerjen e punëve të demontimit/montimit të kushinetave në konstruksionin e pajisjeve të eskavatorit (nuk ka zbatuar nenin 2, paragrafi 2.12 të Rregullores së MPMS nr.2004/01 për masat higjienike dhe teknike të sigurisë në punë); Nuk ka bërë trajnimin e punëtorit U.O nga lëmia e sigurisë dhe mbrojtjes në punë (nuk ka zbatuar nenin 2, paragrafi 2.8 të Ligjit nr.2003/19); Nuk i ka dhënë punëtorit udhëzimet me shkrim për renditjen e operacioneve punuese, masat e sigurisë që duhet ndërmarrë gjatë veprimeve të riparimit në pjesë të caktuara të konstruksionit të eskavatorit; Ka lënë punëtorin të kryejë veprime punuese të karakterit specifik teknik (demontim/montim të kushinetave) pa mbikëqyrje adekuate profesionale, gjë që ka rezultuar me pasoja fatale për punëtorin".* Sa i përket të ndjerit U.O, eksperti përkatës ka evidentuar këtë lëshim: *"Ka pranuar të angazhohet në punë për të cilat nuk ka pasur përgaditje të duhur shkollore, aftësim plotësues profesional, trajnim adekuat e as përvojë pune. Ndërrimi i kushinetave*

në konstruksionin e mekanizmit lëvizës të kundërpeshës së eskavatorit, ka qenë punë që është dashtë të kryhet nga mjeshër të profesionit të ngushtë dhe që kanë përvojë në atë fushë. I ndjeri ka qenë i punësuar si punëtor fizik në kompaninë "B", që në rastin konkret ka mundur vetëm tu ndihmojë mjeshërve duke i furnizuar me vegla pune ose bartje të pjesëve që është dashtë të ndërrohen, por kurrsesi të kycet në veprime të demontimit ose montimit të kushinetave e as pjesëve tjera të eskavatorit (nuk ka zbatuar nenin 3, paragrafi 3.2 të Ligjit Nr.2003/19)."

Nga certifikatat e lindjes për paditësit E, E, E dhe S.O, certifikata e vdekjes për të ndjerin U.O, si dhe deklarata e bashkësisë familjare e dt.21.11.2017, vërtetohet lidhja familjare e paditësve me tani të ndjerin, nga të cilat prova rezulton se paditësja S.O ka qenë bashkëshorte e të ndjerit, paditësja S.O nëna e të ndjerit, ndërsa paditësit E, E, E dhe E.O, fëmijët e të ndjerit.

Nga urdhëri për pagesë periodike i dt.18.08.2012, si dhe gjendja e xhirollogarisë bankare, e lëshuar nga ..., e dt.06.02.2015, vërtetohet fakti se e paditura e parë, N "B", në emër të ndihmës për bashkëshorten e të ndjerit - këtu paditësen S.O, ka paguar në xhirollogarinë e saj bankare nr..., shumë mujore prej 200.00 €, dhe atë nga data 23.02.2010, e deri me datën 01.03.2016, apo shumë e përgjithshme prej 14,800.00 €.

Në procedimin e mëhershëm është nxjerrë prova përmes ekspertizës nga lëmia financiare, e cila është përpiluar nga eksperti financiar A.B me dt.26.12.2017. Përmes kësaj ekspertize është përllogaritur ndryshimi ndërmjet pagesës së besueshme të cilën do ta realizonte i ndjeri U.O, qoftë si i punësuar tek e paditura e parë N "B" apo ndonjë punëdhënës tjetër apo në instancën e fundit nga ekonomizimi në ekonominë familjare dhe krahas kësaj kohë pas kohe si punëtor mëtidtës në tregun e lirë të punës në njëren anë, si dhe ndihmës në shumë mujore prej 200.00 €, të cilën e ka realizuar familja e të ndjerit nga e paditura e parë në anën tjetër. Nga kjo përllogaritje ka rezultuar se ndryshimi për periudhën nga vdekja aksidentale me dt.16.05.2009, e deri me datë 31.12.2017, arrin në shumë prej 12,772.41 €, ndërsa për periudhën nga data 01.01.2018 e deri sa të mos ndryshojnë rrethanat ekonomike në Kosovë, është vlerësuar se paga e besueshme që do të mund të realizonte tani i ndjeri U.O po të ishte të jetë, do të konsistonte në shumë mujore prej 318.00 €.

Në procedimin e mëhershëm po ashtu është nxjerrë prova përmes ekspertizës mjekësore nga lëmia e psikiatrisë, e cila është përpiluar nga eksperti psikiatër Dr. M.K me dt.01.10.2016. Në këtë ekspertizë është konstatuar se:

Paditësja S.O (bashkëshortja e të ndjerit) ka pësuar dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë që kanë zgjatur 6 muaj, dhimbje shpirtërore të intensitetit të mesëm për 1 vit dhe dhimbje shpirtërore të intensitetit të ulët që vazhdojnë edhe sot e kësaj dite, dhimbje shpirtërore këto në formë të pikëllimit të thellë, të manifestuara me shqetësim, mpirje dhe alivanosje, çrregullim të gjumit, rikujtime të ngjarjes traumatike, rënie të vullnetit dhe disponimit, preokupim për kujdesin e fëmijëve të vegjël, ndryshime në funksionet psiko sociale, depresion i prolonguar, si dhe brengë dhe pasiguri për të ardhmën;

Paditësja S.O (nëna e të ndjerit), ka përjetuar dhimbje shpirtërore për shkak të humbjes së jetës së familjarit, dhe atë dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë që kanë zgjatur 6 muaj, dhimbje shpirtërore të intensitetit të mesëm për 1 vit dhe dhimbje shpirtërore të intensitetit të ulët që vazhdojnë edhe sot e kësaj dite, dhimbje shpirtërore kjo në formë të pikëllimit të thellë, e cila është manifestuar me shqetësim, mpirje dhe alivanosje, çrregullim të gjumit, shmangje nga gjësendet e të ndjerit, dhimbje të shtuar në çdo festë familjare apo religjioze, depresion të prolonguar, të shoqeruar me

ankthe dhe stres kronik psikologjik, që ka ndikuar në përkeqësimin e gjendjes së saj, duke marrë parasysh faktin se ka vuajtur nga sëmundjet kronike;

Paditësja E.O (vajza e të ndjerit), ka përjetuar dhimbje shpirtërore për shkak të humbjes së jetës së familjarit dhe atë dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë që kanë zgjatur 6 muaj, dhimbje shpirtërore të intensitetit të mesëm për 9 muaj dhe dhimbje shpirtërore të intensitetit të ulët që vazhdojnë edhe sot e kësaj dite, në formën e pikëllimit të thellë, fillimisht në formë të shqetësimit, mpirjes dhe alivanosjes dhe e manifestuar me çrregullim të gjumit, ëndrra, rikujtime të ngjarjes traumatike, rënie të vullnetit e disponimit, rënie të suksesit e të intensitetit në mësim dhe pamundësi të vijimit të shkollimit, depresion të prolonguar e të tejzgjatur me natyrë të pikëllimit patologjik;

Paditësi E.O (djali i të ndjerit), ka përjetuar dhimbje shpirtërore për shkak të humbjes së jetës së familjarit, dhe atë dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë që kanë zgjatur 5 muaj, dhimbje shpirtërore të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur 8 muaj dhe dhimbje shpirtërore të intensitetit të ulët që vazhdon edhe sot e kësaj dite. Tutje është konstatuar se paditësi duke marrë parasysh atëherë moshën e tij të vogël, me këtë humbje ka përjetuar ndryshime në sferën emocionale dhe të sjelljes, trauma psikologjike, në fillim në formën e shokut emocional dhe ka manifestuar sjellje në formë të shqetësimit, mpirjes dhe alivanosjes, sjellja e tij ka filluar të ndryshojë nga një fëmijë i qetë që ishte më parë. Në sferën emocionale ka përjetuar dhimbje shpirtërore në formë të pikëllimit të thellë, të shoqëruar me çrregullim të gjumit, rikujtime të ngjarjes traumatike, rënie të vullnetit e disponimit, mungesa në shkollë, rënie të suksesit dhe intensitetit në mësim;

Paditësja E.O (vajza e të ndjerit), ka përjetuar dhimbje shpirtërore për shkak të humbjes së jetës së familjarit, dhe atë dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë që ka zgjatur 5 muaj, dhimbje shpirtërore të intensitetit të mesëm që ka zgjatur 8 muaj dhe dhimbje shpirtërore të intensitetit të ulët që vazhdon edhe sot e kësaj dite. Tutje është konstatuar se duke marrë parasysh moshën e saj të re, e njehta ka përjetuar ndryshime në sferën emocionale dhe të sjelljes, traumë psikologjike, fillimisht lajmi për humbjen e babait i ka shkaktuar shok emocional dhe është manifestuar me sjellje në formë të shqetësimit, mpirjes dhe alivanosjes, sjellje e cila ka filluar ta ndryshojë nga një fëmijë gazmor, hap pas hapi në një fëmijë të izoluar nga të tjerët, periudha e pikëllimit të thellë është shoqëruar me ankthe gjatë natës, ëndrra, rikujtime të ngjarjes traumatike, rënie të vullnetit të disponimit, rënie të suksesit dhe intensitetit të mësim, ka përjetuar ndryshime psiko - sociale, e shoqëruar me ankthe dhe stres kronik psikologjik për shkak të mungesës së babait;

Paditësi E.O (djali i të ndjerit), ka përjetuar dhimbje shpirtërore për shkak të humbjes së jetës së familjarit, dhe atë dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë që ka zgjatur 3 muaj, dhimbje shpirtërore të intensitetit të mesëm që ka zgjatur 6 muaj dhe dhimbje shpirtërore të intensitetit të ulët që vazhdon edhe sot e kësaj dite. Tutje është konstatuar se që nga momenti kur ka dëgjuar lajmin për humbjen e babait, ka përjetuar dhimbje shpirtërore në formë të pikëllimit të thellë, të manifestuar me mpirje, humbje të cilën nuk ka mundur ta përballojë, e shoqëruar me frikë të intensitetit të lartë, çrregullim të sjelljes, tërheqje nga lojërat me moshatarët e tij, urinim në shtrat, ankthe gjatë gjumit dhe rikujtime të ngjarjes traumatike, duke e humbur edhe interesin për të gjitha aktivitetet psiko -sociale të cilat i ka zhvilluar më parë.

- Baza ligjore -

Në funksion të vlerësimit të bazës ligjore të kërkesëpadisë së paraqitur, respektivisht pretendimeve të parashtruara nga palët ndërgjyqëse, referuar natyrës dhe momentit kur është krijuar raporti juridik mes palëve ndërgjyqëse, duhet t'i referohemi Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (tani e tutje LMD), të shpallur nga Kuvendi i RSFJ, në seancën e Dhomës Federative me datën 30 mars 1978, ligj ky i cili ka qenë në fuqi deri në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me dt.10.05.2012, i cili ligj ka hyrë në fuqi 6 muaj pas datës së publikimit.

Dispozita nga neni 154 e këtij ligji, e cila i referohet bazës së përgjegjësisë për shkaktimin e dëmit përcakton që: *"Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedh rreziku i shtuar i dëmi për ambientin përgjigjet pavarësisht nga faji. Për dëmin pavarësisht nga faji përgjigjet edhe në raste të tjera të parashikuara me ligj"*. Dispozita e lartëcekur le të nënkuptohet se kemi të bëjmë me dy baza të përgjegjësisë për shkaktimin e dëmit: 1) Përgjegjësia në bazë të fajit dhe 2) Përgjegjësia objektive - pa faj. Dispozita nga neni 155 e të njejtij ligj përcakton definicionin e dëmit dhe është e formuluar në këtë mënyrë: *"Dëmi është pakësim i mjeteve shoqërore, respektivisht i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshem) dhe parandalimi i shtimit të tyre (përfitimi i munguar), si dhe shkak i tjetrit të dhimbjes ose të frikës fizike apo psiqike (demi jomaterial)"*. Detyrimin për shpërblimin e dëmit material e definon dispozita e nenit 185 e këtij ligji, e cila parasheh që: *"Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë kompensim në të holla. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundshme apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që ta bëjë këtë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë dëmtuesit shumën përkatëse në të holla për efekt të kompensimit të dëmit. Gjukata do t'i gjykojë dëmtuesit kompensimin në të holla kur ai e kërkon këtë me përjashtim kur rrethanat e rastit konkrete justifikojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme"*. Dispozita nga neni 194 përcakton që: *"Personi të cilin i vrari e ka ushqyer ose e ka ndihmuar rregullisht, si dhe ai që sipas ligjit ka pasur të drejtë të kërkojë ushqim nga i vrari ka të drejtë kompensimi të dëmit që pëson nga humbja e ushqimit ose të ndihmës. Ky dëm kompensohet me pagimin e rentes në të holla shuma e së cilës caktohet duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit e që nuk mund të jetë më e madhe nga ajo që do të fitonte i dëmtuari nga i vrari po të mbetej gjallë"*. Në anën tjetër, çështja e shpërbimit të dëmit jo material përcaktohet me dispozitën e nenit 200 të LMD-së, e cila parasheh që: *"Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetës të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit për frikën dhe zgjatja e tyre justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi dëmit material dhe nga mungesa e dëmit material. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërbën ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror"*. Dispozita nga neni 201 përcakton që: *"Në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t'u gjykojë anëtarëve të familjes së tij të ngushte (bashkëshorti, fëmijët dhe prindërit) kompensim të drejtë në të holla për dhimbjet e tyre shpirtërore."*

Gjykata iu referua edhe nenit 897 të LMD-së, e cila përcakton nocionin e kontratës mbi sigurimin dhe është e formuluar në këtë mënyrë: *"Me kontratën mbi sigurimin obligohet kontraktuesi i sigurimit që mbi parimet e reciprocitetit e të solidaritetit të bashkojë një shumë të caktuar në bashkësinë e sigurimeve respektivisht në bashkësinë e rrezikut (siguruesi), kurse bashkësia obligohet që nëse ndodhë ngjarja që paraqet rastin e siguruar, t'i paguajë siguruesit apo ndonjë personit të tretë kompensimin, respektivisht shumën e kontraktuar që të kryejë diçka tjetër"*. Tutje, dispozita nga neni 898 e këtij ligji, e cila i referohet rastit të siguruar përcakton që: *"Ngjarja duke marrë parasysh se për cilën lidhet sigurimi (rasti i siguruar) duhet të jetë e ardhshme e pasigurtë dhe e pavarur nga dëshira ekskluzive e kontraktuesve"*. Neni 901 i këtij ligji përcakton që: *"Kontrata mbi sigurimin quhet e lidhur kur kontraktuesit nënshkruajnë policën e sigurimit ose fletë-depozitën"*, ndërsa neni 902 përcakton: *"Në policë duhet të shkruhen palët kontraktuese, sendi i siguruar, respektivisht personi i siguruar, rreziku i përfshirë nga sigurimi, kohëzgjatja e sigurimit dhe periudha e depozitës, shuma e sigurimit ose se sigurimi është i pakufizuar, primia ose kontributi, data e dhënies së policës dhe nënshkrimet e palëve kontraktuese"*.

Së fundmi, Gjykata iu referua edhe Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë Nr.2003/19, i cili ligj ka hyrë në fuqi me dt.06.11.2003 dhe ka gjetur zbatim deri në hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 16.05.2013. Në dispozitën e nenit 1, par.1, 2 dhe 3 të këtij ligji, përcaktohet shprehimisht që: *"1.1 Qëllimi i Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, është që të parandalohen lëndimet në punë, sëmundjet profesionale në vendin e punës dhe të mbrohet ambienti i punës. 1.2 Vendi i punës është çdo hapësirë punuese ku kryhet veprimtari pune. 1.3 Siguria në punë, mbrojtja e shëndetit të të punësuarve dhe e ambientit të punës është pjesë integrale e organizimit të punës dhe e procesit të punës. Ajo duhet të vëhet në funksion përmes aktivitetit të punëdhënësit dhe të punëmarrësit (termat: punëdhënës dhe punëmarrës janë të definuara në, Rregullorja Nr.2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, (neni 9, paragrafi 9.2 dhe paragrafi 9.3), përmes marrëveshjeve obliguese, rregullave të kontraktuara dhe të pranuar për siguri në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës, masave tjera shtuese dhe udhëzimeve të përcaktuara nga punëdhënësi"*. Në nenin 2 të këtij ligji janë të numëruara të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë e punëdhënësit, ndërsa në nenin 3 të drejtat dhe përgjegjësitë e punëmarrësit.

- Vlerësimi i Gjykatës -

Mbi bazën e provave të administruara më sipër, e në referim ndërlidhës me dispozitat ligjore të lartëcituar nga e drejta materiale, rrjedh se paditësit, si pasojë e humbjes së jetës së anëtarit të familjes U.O nga aksidenti në vendin e punës me datë 16.05.2009, kanë pësuar dëm jo material, (i cili konsiston në dhimbje shpirtërore), si dhe dëm material, (i cili konsiston në humbjen e mbajtjes, shpenzime të varrimit, ngritje të lapidarit si dhe shpenzimet për pritjen dhe përcjelljen në ngushëllime). Se është fakt i pakontestueshëm që të njejtëve në cilësinë e familjarëve u takon e drejta në kompensim, është pasqyruar edhe në arsyetimin e aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4186/18, të dt.18.08.2022, respektivisht në paragrafin 1 të faqes 5 të arsyetimit. Fakt vendimtar për tu sqaruar në këtë çështje kontestimore, bazuar edhe në pikëpamjet dhe udhëzimet e parashtruara përmes aktvendimit të lartëcekur të Gjykatës së Apelit, konsiston në sqarimin e çështjes se cila prej të paditurave e ka për detyrim të kompensojë paditësit për dëmet e pësuar, respektivisht për cilat kategori dhe forma të dëmit dhe mbi cilën bazë, atë që rrjedhë nga polica për sigurim shëndetësor apo të përgjegjësisë objektive - pa faj. Mbi bazën e këtyre pikëpamjeve, vlerësimi i Gjykatës

konsiston në faktin se duhet bërë ndarja e përgjegjësisë, gjegjësisht është e përjashtuar përgjegjësia solidare e të paditurave lidhur me kompensimin e të gjitha formave të dëmit për paditësit. Po ashtu, mbi bazën e një linje të tillë të vlerësimit, bie poshtë edhe pretendimi i të paditurës së parë, N “B”, i parashtruar në fjalën përfundimtare, se me rastin e sigurimit të tani të ndjerit U.O tek e paditura e dytë Kompania e Sigurimeve “S”, përmes policës së sigurimit nr..., të gjitha obligimet për kompensim kalojnë tek kjo e fundit, duke pretenduar në këtë mënyrë se i vetmi subjekt që ka legjitimitet pasiv dhe mund të konsiderohet përgjegjës për shpërblimin e dëmit ndaj paditësve është pikërisht e paditura e dytë.

Në raport me përgjegjësinë e të paditurës së parë, N “B”, duhet përqendruar vëmendjen tek disa rrethana kyçe: Fillimisht, i ndjeri U.O dhe e paditura kanë qenë në marrëdhënie kontraktuale të punës për periudhën kohore 03.01.2009 deri me datë 03.01.2010, me mundësi vazhdimi. Sipas kësaj kontrate, është specifikuar në mënyrë të qartë se tani i ndjeri është sistemuar në vendin e punës punëtor fizik, ndërsa punët e përcaktuara do të kryhen në selinë e punëdhënësit (nenet 2 dhe 3 të Kontratës). Në nenin 10 të Kontratës është theksuar se me rastin e punësimit, punonjësi është njoftuar me rregullat e mbrojtjes në punë si dhe pasojat e mundshme për mos zbatim të këtyre rregullave apo mos përdorimit të masave mbrojtëse. Aplikimi i këtyre rregullave vlen për pozitën në të cilën ka qenë i sistemuar punonjësi - atë të punëtorit fizik, pozitë kjo e cila i është përgjigjur kualifikimit dhe përgaditjes profesionale të tani të ndjerit.

Po ashtu, vlen të theksohet fakti se marrëveshja me subjektin “R.E”, me të cilën e paditura e parë është dakorduar që subjektit të lartëcekur t'i ofrojë kontraktuesit shërbime teknike (fuqi punëtore), në funksion të realizimit të projektit "*Riparimi i eskavatorit Rotorik E10 në MS B*", është lidhur me dt.25.10.2008, pra në një periudhë kohore që përkon para themelimit të marrëdhënies së punës mes të paditurës së parë dhe tani të ndjerit U.O. Në këtë mënyrë, me rastin e ofrimit të shërbimit (mbështetjes më fuqi punëtore), përmes dërgimit të tani të ndjerit për të kryer punë në dobi të subjektit “R.E”, e paditura e parë ka qenë e vetëdijshme dhe ka pasur njohuri të mjaftueshme lidhur me përgaditjen profesionale dhe kualifikimin e të njejtit. Një veprim i tillë, për më tepër paraqet shmangje të disa dispozitave të kontratës bazë të punës të dt.03.01.2009, që është manifestuar përmes sistemimit të punonjësit në një vend të punës që nuk përkon me atë që ka qenë i sistemuar sipas kontratës dhe me detyrimin e të njejtit që të kryejë punë jashtë selisë së punëdhënësit.

Një faktor tjetër i rëndësishëm për tu theksuar konsiston në atë që në marrëveshjen e lidhur mes të paditurës së parë dhe “R.E”, nuk janë implikuar fare çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes në punë gjatë realizimit të punimeve sipas kësaj marrëveshje, si dhe nuk është bërë vlerësimi i rrezikshmërisë së vendeve të punës dhe konform nivelit të rrezikut të parashihen dhe ndërmerren masat adekuate parandaluese. Si pasojë e lëshimeve të tilla, për të kryer punët e montimit/demontimit është angazhuar një punonjës i cili rezulton se nuk e ka pasur përgaditjen e duhur profesionale dhe trajnimet e nevojshme për kryerjen e punëve të natyrës së tillë, duke u ekzpozuar ndaj rrezikut potencial për shëndetin dhe jetën e tij. Në këtë mënyrë, rezulton se e paditura e parë nuk i ka përmbushur në tërësi obligimet të cilat burojnë nga dispozita e nenit 2 të Ligjit Nr.2003/19 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Ekziston një pritshmëri e arsyeshme që subjekti punëdhënës duhet të tregojë një nivel të lartë të përgjegjësisë në drejtim të respektimit të obligimeve të cilat rrjedhin nga mekanizmat ligjorë që e rregullojnë materien e mbrojtjes dhe sigurisë në vendin e punës në raport me të punësuarit.

Të gjitha lëshimet e lartëcekura janë evidentuar fillimisht në raportin zyrtar të TEIP, nr.42/09, të datës 15.07.2009, për të cilat lëshime të paditurës së parë i është shqiptuar edhe një gjobë në shumën

prej 9,500 €, e veçanërisht në ekspertizën nga lëmia e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, të përpiluar nga eksperti Dr.sc.A.K, me ç'rast është konstatuar se e paditura e parë ka bërë gjithsej 7 lëshime të cilat i kanë kontribuar aksidentit me pasoja fatale për të ndjerin, lëshime këto të cilat janë numëruar dhe elaboruar në detaje në pjesën e mësipërme të arsyetimit të këtij aktgjykimi. Gjykata mori në konsideratë faktin se po në këtë ekspertizë, lëshimet lidhur me aksidentin vdekjeprurës nuk i atribuohen në tërësi të paditurës së parë, por edhe subjektit "R.E", si dhe të punësuarit - tani të ndjerit U.O. Në raport me të punësuarin, sipas ekspertizës është evidentuar vetëm një lëshim, e që ka të bëjë me faktin se i njëjti ka pranuar të angazhohet në punë për të cilat nuk ka pasur përgaditje të duhur shkollore, aftësim plotësues profesional, trajnim adekuat e as përvojë pune. Në sqarimin plotësues të ekspertit nga lëmia e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, të dhënë në seancën e dt.26.04.2024, i njëjti ka theksuar se lëshimi dhe kontributi i punëtorit në ngjarjen e ndodhur është minimal. Në anën tjetër, lëshimet të cilat janë evidentuar për subjektin "R.E", Gjykata nuk mund t'i marrë në konsideratë me rastin e vendimmarrjes lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë, për faktin se kemi të bëjmë me një subjekt i cili nuk është palë në këtë procedurë, gjegjësisht subjekt ndaj të cilit nuk është paraqitur ndonjë kërkesë për kompensim nga palët paditëse. Thënë kjo, fakti se lëshimet nuk i atribuohen ekskluzivisht të paditurës së parë, N "B", nuk e përjashton lidhjen kauzale ndërmjet lëshimeve të konstatuara nga e paditura e lartëcekur në raport me dëmin e shkaktuar, por gjithsesi trajtohet si rrethanë me ndikim dhe peshë në vlerësimin e nivelit të përgjegjësisë për këtë të paditur në raport me detyrimin për kompensim.

Kur bëhet fjalë për ekspertizën nga lëmia e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, të përpiluar nga eksperti Dr.Sc.A.K me dt.14.3.2024, e plotësuar me sqarimet shtesë të dhëna në seancën e dt.26.04.2024, Gjykata vendosi t'ia falë besimin e plotë kësaj ekspertize, me argumentin se janë sqaruar të gjitha rrethanat e nevojshme të cilat Gjykatës i shërbejnë në funksion të krijimit të bindjes për marrjen e vendimit në këtë çështje kontestimore. Në anën tjetër, sa i përket ekspertizës nga lëmia e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, e cila është përpiluar nga eksperti Dr.B.B - inxhinier i makinerisë me dt.05.05.2016, meqenëse për shkaqet e elaboruara më sipër, eksperti i cili e ka përpiluar ekspertizën e ka pasur të pamundur të prezantojë në seancë dhe të japë sqarimet plotësuese sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, kjo Gjykatë nuk mund ta trajtojë si provë relevante në drejtim të sqarimit të rrethanave të ndodhjes së aksidentit në vendin e punës me pasoja vdekjeprurëse.

Gjykata mori në konsideratë pretendimin e palës së paditur, lidhur me faktin se i ndjeri në momentin e aksidentit me pasoja vdekjeprurëse ka qenë duke kryer punë dhe detyra në objektin e "R.E", nën mbikëqyrjen e personelit të kësaj të fundit, duke aluduar në këtë mënyrë se kemi të bëjmë me situatë të sistemimit të përkohshëm të të punësuarit tek një punëdhënës tjetër me pëlqimin e tij, në kuptim të nenit 19 par.1, lidhur me par.3 të Ligjit të Punës. Në raport me këtë pretendim, fillimisht duhet sjellë në vëmendje se është fakt i pakontestueshëm që tani i ndjeri, në momentin e ndodhjes së aksidentit me pasoja vdekjeprurëse ka qenë duke kryer punë dhe detyra në dobi të subjektit "R.E". Megjithatë, po ashtu vlen të potencohet fakti se i ndjeri nuk ka qenë asnjëherë në marrëdhënie kontraktuale të punës me këtë subjekt, por pikërisht me të paditurën e parë, e cila e ka marrë bashkërisht vendimin për ta dërguar të njëjtin për të kryer punë në funksion të një subjekti tjetër, në këtë rast "R.E", pavarësisht mungesës së kualifikimit dhe përgaditjes së të njëjtit, me ç'rast ka ardhur deri te aksidenti me pasoja vdekjeprurëse. Fokusi i vlerësimit të rrethanave dhe shkaqeve të cilat kanë kontribuar deri te aksidenti me pasoja vdekjeprurëse nuk duhet përqendruar dhe kufizuar vetëm në raport me periudhën kohore kur ka ndodhur aksidenti përkatës, por në kuadër të një konteksti dhe hapësire më të gjerë kohore. Lidhur me referimin e të paditurës në dispozitën e nenit 19 par.1 dhe 3

të Ligjit të Punës, e cila ka të bëjë me sistemimin e të punësuarit me pëlqimin e tij, Gjykata vë në pah faktin se ligji i cituar është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.11.2010 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit, ndërsa aksidenti me pasoja vdekjeprurëse për tani të ndjerin U.O ka ndodhur me datë 16.05.2009, që nënkupton se dispozitat nga ligji i lartëcekur nuk mund të gjejnë zbatim në rastin konkret. Nuk duhet anashkaluar edhe faktin se në kontratën e punës mes të paditurës së parë dhe tani të ndjerit, me asnjë dispozitë nuk është parashikuar mundësia e sistemimit të përkohshëm të punonjësit tek ndonjë subjekt tjetër jashtë punëdhënësit me pëlqimin e tij. Një procedurë e tillë nuk realizohet thjeshtë përmes formës verbale, por i nënshtrohet disa rregullave formale strikte, të cilat në rastin konkret nuk rezultojnë të kenë ardhur në shprehje.

Si përfundim, në bazë të të gjitha rrethanave të elaboruara më sipër, Gjykata vlerëson se në raport me të paditurën e parë vjen në shprehje baza e përgjegjësisë objektive - pa faj. Mbi këtë bazë, vendosi që në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër të dëmit jo material, për dhimbjet shpirtërore të përjetuara për paditësit si pasojë e humbjes së jetës së anëtarit të familjes, ta detyrojë të paditurën e parë që t'ua paguajë shumat si në vijim: paditëses S.O, shumën prej 5,000 €; paditëses S.O, shumën prej 5,000 €; paditësit E.O, shumën prej 3,500 €; paditësit E.O, shumën prej 2,500 € dhe paditëses E.O, shumën prej 3,700 €. Me rastin e vendosjes lidhur me këto shuma, është marrë në referencë intensiteti dhe kohëzgjatja e dhimbjeve shpirtërore të përjetuara për secilin prej paditësve, të konstatuara në ekspertizën e përpiluar nga eksperti nga lëmia e psikiatrisë Dr. M.K me dt.01.10.2016, të gjeturat e së cilës ekspertizë janë evidentuar në pjesën e mësipërme të arsytimit të këtij aktgjykimi. Ekspertizës së lartëcekur, Gjykata vendosi t'ia falë besimin e plotë, mbi bazën e vlerësimit se e njejta është përpiluar në mënyrë profesionale, duke i marrë parasysh të gjithë parametrat e nevojshëm dhe për më tepër të gjeturat e kësaj ekspertize nuk janë kontestuar nga ana e palëve ndëregjyqëse. Bazuar në këto rrethana, Gjykata vendosi në kuptim të dispozitës nga neni 201 të LMD-së, duke gjykuar shumat e specifikuara më sipër, me bindjen se këto shuma paraqesin një lloj satisfakcioni moral në raport me cenimin që u është bërë paditësve, ndërsa me rastin e vendosjes lidhur me këtë kërkesë është marrë në konsideratë rëndësia e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim.

Lidhur me shumat e gjykuara në emër të dëmit jo material, Gjykata iu referua edhe Udhëzuesit të Gjykatës Supreme të Kosovës, GJ.A – Su.A 41/2023, të dt.27.02.2023, me të cilin janë përcaktuar disa kritere orientuese lidhur me lartësinë e shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material.

Gjykata po ashtu vendosi që ta obligojë të paditurën e parë, N “B”, që në emër të rentës për mbajtje, për periudhën kohore 16.05.2009 - 31.12.2017, t'ua paguajë paditësve shumën e përgjithshme në vlerë prej 12,772.41 €, ndërsa për periudhën nga data 01.01.2018, e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, në emër të pagës së besueshme që do të mund ta realizonte tani i ndjeri U.O po të ishte në jetë, shumën prej 318.00 € për çdo muaj, dhe atë më së largu deri me datën 05 të çdo muaji vijues. Një formë të tillë të vendosjes, Gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 194 të LMD-së, duke e marrë në konsideratë edhe ekspertizën nga lëmia financiare, e cila është përpiluar nga eksperti financiar A.B me dt.26.12.2017. Përmes kësaj ekspertize është përllogaritur ndryshimi ndërmjet pagesës së besueshme të cilën do ta realizonte i ndjeri U.O, qoftë si i punësuar tek e paditura e parë N “B” apo ndonjë punëdhënës tjetër apo në instancën e fundit nga ekonomizimi në ekonominë familjare dhe krahas kësaj kohë pas kohe si punëtor mëtidtës në tregun e lirë të punës në njërin anë, si dhe ndihmës në shumën mujore prej 200.00 €, të cilën e ka realizuar familja e të ndjerit nga e paditura e parë në anën tjetër. Nga kjo përllogaritje ka rezultuar se ndryshimi për periudhën nga vdekja aksidentale me dt.16.05.2009, e deri me datë 31.12.2017, arrin në shumën prej 12,772.41 €,

ndërsa për periudhën nga data 01.01.2018 e deri sa të mos ndryshojnë rrethanat ekonomike në Kosovë, është vlerësuar se paga e besueshme që do të mund të realizonte tani i ndjeri U.O po të ishte të jetë, do të konsistonte në shumën mujore prej 318.00 €. Ekspertizës së lartëcekur Gjykata po ashtu ia fali besimin e plotë, për faktin se është përpiluar në mënyrë profesionale dhe ngjashëm sikurse ekspertiza nga lëmia e psikiatrisë, të gjeturat nga kjo ekspertizë nuk janë kontestuar nga palët ndërgjyqëse.

Në raport me të paditurën e dytë, Kompania e Sigurimeve “S”, me seli në P, Gjykata fillimisht mori në konsideratë faktin se aksidenti me pasoja vdekjeprurëse ka ndodhur me datë 16.05.2009, periudhë kohore kjo gjatë së cilës tani i ndjeri U.O ka pasur mbulueshmëri të sigurimit nga aksidentet personale sipas policës së sigurimit nr..., përmes së cilës e paditura e parë kishte siguruar në mënyrë kolektive nga aksidentet personale 22 të punësuar tek e paditura e dytë, me kohëzgjatje për periudhën kohore 26.01.2009 - 26.01.2010. Në mesin e punonjësve të siguruar bën pjesë edhe tani i ndjeri U.O, fakt ky i cili vërtetohet edhe në bazë të certifikatës së sigurimit nr..., të dt.26.01.2009. Në këtë mënyrë, për të paditurën e dytë, si palë siguroese vjen në shprehje baza e përgjegjësisë kontraktuale për kompensimin e dëmit, në kuptim të dispozitës së lartëcekur nga neni 897, lidhur me nenin 154 të LMD-së, përkatësisht mbi bazën e këtyre dispozitave rrjedh obligimi i të njejtës për kompensimin e paditësve. Lidhur me faktin se çka mbulon polica, respektivisht certifikata e sigurimit për tani të ndjerin, Gjykata erdhi në përfundim se në këtë policë nuk janë specifikuar në mënyrë taksative format apo kategoritë e dëmit të cilat i nënshtrohen kompensimit, mirëpo nga vështrimi i këtyre dokumenteve mund të konstatohet fakti se shuma maksimale e mbulueshmërinë për të siguarin - tani të ndjerin në rast të ndonjë aksidenti personal në vendin e punës konsiston në shumën prej 2,000 Euro, ndërsa në kuadër të kësaj shume nuk është përfshirë detyrimi për kompensimin e formave të dëmit jo material – dhimbjeve shpirtërore për humbjen e anëtarit të familjes.

Mbi këtë bazë, Gjykata vendosi që ta detyrojë të paditurën e dytë që paditësve, në emër të kompenzimit të dëmit material të shkaktuar si pasojë e humbjes së jetës së anëtarit të familjes, t'ua kompensojë shumat si në vijim: për shpenzimet e varrimit, shumën prej 400.00 €, për ngritjen e lapidarit për të ndjerin U.O, shumën prej 800.00 €, si dhe për pritjen dhe përcjelljen në ngushëllime, shumën prej 600.00 €.

Gjykata sjellë në vëmendje faktin se për këto kategori të dëmit material, ndonëse ka qenë e mundur që të argumentohet që kanë ardhur në shprehje me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes, në praktikë është dukshëm e vështirësuar për tu argumentuar nga ana e paditësve lartësia e saktë e shpenzimeve të krijuara përmes prezantimit të provave materiale konkrete. Në këtë kuptim, është përcaktuar një standard që duhet vepruar në bazë të çmuarjes së lirë të Gjykatës, me rastin e vendosjes së një shpërblimi adekuat për këto lloje të dëmit, në mbështetje të dispozitës nga neni 323 të LPK-së, e cila përcakton që: *“Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t’i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tilla do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë”*. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se shumat e gjykuara sa i përket kësaj pjese të vendosjes, janë të mjaftueshme për ta kthyer gjendjen materiale të të dëmtuarve - këtu paditësve në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë para se të shkaktohej dëmi. Për më tepër, shumat e tilla të gjykuara i përgjigjen nivelit të mbulueshmërisë së përcaktuar që ofron polica, gjegjësisht certifikata e sigurimit për tani të ndjerin U.O.

- Pjesa refuzuese e kërkesëpadisë -

Gjykata në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e refuzoi pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve ndaj të paditurave, përtej shumave të gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë: në emër të dëmit jo - material - dhimbjeve shpirtërore të përjetuara, për paditësen S.O, në shumën prej 4,000 €, për paditësen S.O, në shumën prej 4,000 €, për paditësin E.O, në shumën prej 5,500 €, për paditësin E.O, në shumën prej 6,500 €, për paditësen E.O, në shumën prej 5,300 €, si dhe për paditësen E.O, në shumën prej 5,000 €. Po ashtu, është refuzuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve ndaj të paditurave përtej shumave të gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi në emër të dëmit material, dhe atë: për shpenzimet e varrimit në shumën prej 550.00 €, për ngritjen e lapidarit për të ndjerin U.O, në shumën prej 700.00 €, si dhe për pritjen dhe përcjelljen në ngushëllime në shumën prej 900.00 €. Kjo për faktin se çfarëdo shume e gjykuar përtej atyre që u është njohur paditësve në emër të kompensimit të këtyre formave të dëmit, nuk do të ishte në proporcion të plotë me intensitetin apo vëllimin e dëmit të pësuar dhe do ta tejkalonte qëllimin të cilit i shërben një shpërblim i tillë. Gjykata sjellë në vëmendje faktin se qëllimi i realizimit të kërkesës për kompensim nuk ka të bëjë me pasurimin e palës e cila e ka parashtruar kërkesën, por me kthimin e një gjendje e cila ka qenë para shkakimit të dëmit, respektivisht ofrimin e një satisfacioni moral për palën e dëmtuar në raport me të mirën e cënuar. Në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë, Gjykata po ashtu ka marrë në konsideratë nivelin e kontributit të tani të ndjerit U.O në shkaktimin e aksidentit me pasojë vdekjeprurëse, të evidentuar në ekspertizën nga lëmia e mbrojtjes dhe sigurisë në punë.

- Vendimi lidhur me kamatën –

Gjykata në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi vendosi lidhur me kërkesën aksesore, duke i detyruar të paditurat që shumat e gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ua paguajnë paditësve së bashku me normën e kamatës e cila vlen si për mjetet e depozituara në bankat afariste që operojnë në Republikës e Kosovës, në afat më tepër se një vit, pa destinim të caktuar, e cila për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit, dt.13.05.2024, e deri në pagesën definitive, ndërsa për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit material, do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë, dt.26.10.2009, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë. Një vendosje e tillë gjen mbështetje në dispozitën nga neni 377 të LMD-së, e cila parasheh që: "*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos kryegjësë, edhe kamatën sipas shkallës, e cila në vendin e përmbushjes paguhet në depozimet e kursimit me të parë*". Gjykata me rastin e përcaktimit të periudhës kohore nga e cila fillon të rrjedhë kamata për të dy format e dëmit (jo material dhe material) iu referua Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr.265/2020, të dt.02.12.2020, konkretisht pjesës së tretë, pikave XIV dhe XV të këtij Mendimi.

- Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës -

Në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata vendosi lidhur me shpenzimet e procedurës, në atë mënyrë që fillimisht e detyroi të paditurën e parë, N "B", me seli në fshatin B, Komuna F.K, që në emër të shpenzimeve të procedurës t'ua paguajë paditësve shumën prej 6,725.00 €, ndërsa të paditurën e dytë, Kompania e Sigurimeve "S", me seli në P, shumën prej 330.90 €. Lidhur me këtë mënyrë të vendosjes, Gjykata iu referua dispozitës nga neni 452 par.2 të LPK-së, e cila përcakton që: "*Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke*

marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t'ia shpërblejë tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve". Në rastin konkret, përfaqësuesi i autorizuar i paditësve në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar ka paraqitur kërkesë të specifikuar për kompensimin e shpenzimeve në vlerën e tërësishme prej 13,080,40 Euro. Gjykata mori në konsideratë faktin se nga tërësia e vlerës së kontestit prej 70,922.00 €, pjesa e aprovuar e kërkesëpadisë në raport me të paditurën e parë konsiston në shumën prej 36,472.00 Euro, që nënkupton se shkalla e përgjithshme e suksesit në këtë procedure në raport me këtë të paditur arrin në nivelin prej 51.42 %. Në anën tjetër, nga tërësia e vlerës së kontestit prej 70,922.00 €, pjesa e aprovuar e kërkesëpadisë në raport me të paditurën e dytë konsiston në shumën prej 1,800.00 Euro, që nënkupton se shkalla e përgjithshme e suksesit në këtë procedure në raport me këtë të paditur arrin në nivelin prej 2.53 %.

Mbi këtë bazë, Gjykata erdhi në përfundim se paditësve, nga e paditura e parë duhet tu kompensohen shpenzimet e kësaj procedure në shumën prej 6,725 Euro, ($13,080.40 \times 51.42\% = 6725$), ndërsa nga e paditura e dytë duhet t'i kompensohen shpenzimet në shumën prej 330.90 Euro ($13.080.40 \times 2.53\% = 330.90$), shumë kjo proporcionale me suksesin e arritur në procedurë. Sa i përket lartësisë së shpenzimeve, Gjykata iu referua Rregullores për Tarifat e Avokatëve, specifikisht numrave tariforë 6 dhe 7.

Bazuar në të lartëcekurat, në mbështetje të dispozitës së nenit 160 të LPK-së, u vendos decidivisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil-
C.nr.4540/22, datë 13.05.2024

G j y q t a r i,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, në kuptim të dispozitës nga neni 176 të LPK-së, palët e pakënaqura kanë të drejtën e ankesës në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.